




REPUBLICAN KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr Prot.	03-02/4607/16
Dep.		Br Prot.	
Dep.		Prot No	
Nr. l'faq		Data	
Broj stranica	02	Datum	09-12-2016
Nr. pages		Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2961/16, për z. Bashkim Nexhipi, Koordinator i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesi dhe papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për z. Bashkim Nexhipi, Koordinator i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht e ka njoftuar z. Bashkim Nexhipi me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast na ka njoftuar se funksioni Koordinator i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport nuk është pozitë barasvlershme me Drejtorët e Drejtorive Komunale në Komunën e Gjilanit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, në neni 4 ka përcaktuar zyrtarët e lartë publik të cilët i nënshtrohen zbatimit të këtij Ligji.

Duke u bazuar në Statutin e Komunës së Gjilanit, si dhe kontratën e punës, funksioni Koordinator i Njësisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit, nuk është funksion i cili hynë në mesin e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

